

KËRKESË
Nr. 96, datë 14.1.2020

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV NDAJ SUBJEKTIT “NERTIL GERXHOLLI”

ISHSH-ja, Dega Rajonale Qarku Vlorë, meqenëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin përfundimtar të inspektimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë (në adresën ku kryen aktivitet dhe në adresën e pasqyruar në QKB), duke u konfirmuar nga shërbimi postar: larguar.

Sa më sipër, ISHSH-ja, Dega Rajonale Qarku Vlorë, duke qenë se Posta Shqiptare e ka të pamundur komunikimin e masës administrative, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit nr. ISHSH VL-2019 000195-5, datë 1.3.2019 për subjektin “Nertil Gerxholli”, me adresë: Qarku Vlorë, Sarandë, lagjja nr. 3, rruga “Adem Sheme”, godinë 1-katëshe.

KRYEINSPEKTOR
Pandeli Bilbilaj

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHSH-VL-2019-000195-5

Datë 1.3.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, në VKM-në nr. 241, datë 27.3.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor”, dhe në procesverbalin e inspektimit nr. ISHSH-VL-2019-000195-2, datë 1.3.2019, inspektim që është zhvilluar në subjektin “Nertil Gerxholli”, NIPT: L74306803A, punëdhënës përfaqësuesi i subjektit “Nertil Gerxholli” nuk ndodhet në subjekt në momentin e inspektimit. Në subjekt u gjet personeli, prej datës 3.1.2019, ora 11:15:00 deri në datën 3.1.2019, ora 11:45:00.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datën 1.3.2019 dhe e njoftoi në datën 1.3.2019. Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe të kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligji nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar, neni 15/d.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit, **moszbatimi i ligjit antiduhan**, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

Gjobë 300 000 lekë

Gjobë

2. Dënim administrativ plotësues:

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive:

-
Shuma e shpenzimeve për përzgjedhjen, transportin dhe ekzaminimin apo analizën e mostrave. --

Inspektorët shtetërorë të autorizuar:

Elona Mano ID

Jola Osmeni ID

Pavjola Zeneli ID 0412080008

Personi i autorizuar i subjektit

Përfaqësuesi i subjektit “Nertil Gerxholli” nuk ndodhet në subjekt në momentin e inspektimit. Në subjekt u gjet personeli.

Kundër vendimit përfundimtar të inspektimit, subjekti “Nertil Gerxholli” ka të drejtën e ankimit, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë organit epror të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.